



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI SHTETËROR PËR
INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR

SHKOLLA SHQIPTARE E
ADMINISTRATËS PUBLIKE

Nr. 384 Prot.

Nr. 781 Prot.

Tiranë, më 04.07.2024

Tiranë, më 04.07.2024

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

**AUTORITETIT SHTETËROR PËR INFORMACIONIN
GJEOHAPËSINOR**

dhe

SHKOLLËS SHQIPTARE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE

Sot, më datë 04 / 07 / 2024 lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet palëve si më poshtë vijon:

Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), institucion publik qendror, me NIPT L31919452G dhe adresë: Rruga "Papa Gjon Pali II" Nr. 3, 1010 Tiranë, i krijuar me ligjin nr. 72/2012, datë 28.06.2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë", përfaqësuar nga **Znj. Vilma TOMÇO, Drejtor i Përgjithshëm;**

(në vazhdim ASIG)

dhe

Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASP), institucion publik qendror, me NIPT L31720451U dhe adresë Bulevardi "Zhan D'Ark" Nr. 31, Tiranë, i krijuar me ligjin nr 152/2013 "Për Nëpunësin Civil" dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr 138 datë 12.03.2014 "Për rregullat e organizimit e të funksionimit të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike", me

autonomi administrative dhe akademike që ka për qëllim formimin e nëpunësve të pushtetit qendror, pushtetit vendor, si dhe institucioneve të pavarura, përfaqësuar nga **Znj. Arlinda Hoti, Drejtor i Deleguar;**
(në vazhdim ASPA)

Këtu e më poshtë referuar individualisht si “**Pala**” ose bashkërisht si “**Palët**”.

Baza ligjore

Kjo marrëveshje është hartuar në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 72/2012, datë 28.06.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 138 datë 12.03.2014 “Për rregullat e organizimit e të funksionimit të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, trajnimin e nëpunësve civilë, si dhe të çdo individi tjetër jashtë shërbimit civil”.

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj *Marrëveshjeje* është të rregullojë dhe të institucionalizojë marrëdhënien e bashkëpunimit midis palëve, për zhvillimin e kapaciteteve të nëpunësve të administratës publike në fushën e gjeoinformacionit, përmes realizimit të trajnimeve të integruara, sipas përcaktimeve të kësaj marrëveshjeje.

Neni 2

Fushat e bashkëpunimit

Për përmbushjen e qëllimit të kësaj *Marrëveshjejeje*, fushat e bashkëpunimit do të fokusohen në:

- 2.1 Kombinimin e burimeve dhe ekspertizës për të ofruar trajnime të përbashkëta në fushën e gjeoinformacionit;
- 2.2 Hartimin e kurrikulave të dedikuara për tematikat e gjeoinformacionit për administratën publike;
- 2.3 Organizimin e përbashkët të trajnimeve me qëllim rritjen e kapaciteteve të nëpunësve të administratës publike në fushën e gjeoinformacionit.

Neni 3

Angazhimet dhe të drejtat e ASIG :

- 3.1 ASIG merr përsipër të propozojë ekspertë të fushës për hartimin dhe zhvillimin e kurrikulave për trajnimet në sektorin e gjeoinformacionit bazuar në standardet dhe zhvillimet teknologjike të fushës së informacionit gjeohapësinor dhe procedurave të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA).



- 3.2 ASIG merr përsipër të propozojë trajnerë të specializuar për realizimin e sesioneve informuese, workshop-eve dhe trajnimeve me qëllim zhvillimin e kapaciteteve të nëpunësve të administratës publike, për njohuritë që lidhen ngushtësisht me fushën e gjeoinformacionit.
- 3.3 ASIG ka të drejtë të propozojë tematikat e trajnimeve për fushën e gjeoinformacionit sipas nevojave të identifikuara për rritjen e kapaciteteve të nëpunësve të administratës publike.

Neni 4

Angazhimet dhe të drejtat e ASPA

- 4.1 ASPA angazhohet të ofrojë mbështetje logjistike për realizimin e trajnimeve në fushën e gjeoinformacionit nëpërmjet sigurimit të ambienteve ose platformave për zhvillimin e trajnimeve online.
- 4.2 ASPA, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse pranë ASIG, ka të drejtë të ndjekë procedurat, standardet, metodologjitë për planifikimin dhe menaxhimin e zhvillimit të ciklit të plotë të trajnimit në fushën e gjeoinformacionit.
- 4.3 ASPA, në përfundim të trajnimit angazhohet të pajisë pjesëmarrësit me certifikatë në bashkëpunim me ASIG.

Neni 5

Kohëzgjatja e marrëveshjes

- 5.1 Kjo marrëveshje bashkëpunimi nënshkruhet nga palët pa afat dhe i shtrin efektet nga momenti i nënshkrimit të saj.
- 5.2 Kjo marrëveshje bashkëpunimi mund të zgjidhet në çdo kohë nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar palës tjetër.

Neni 6

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve midis palëve

- 6.1 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje, apo të ndonjë marrëveshjeje tjetër, ose dokumenti të nënshkruar nga palët për zbatimin e saj, do të zgjidhet miqësisht nga palët, në të kundërt do të aplikohen përcaktimet e legjislacionit në fuqi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve civile.

Neni 7

Njoftimet mes palëve

- 7.1 Çdo njoftim si dhe komunikim midis palëve lidhur me ndryshimet, shtesat apo me plotësimet që mund të lindin me kalimin e kohës për të realizuar këtë marrëveshje bashkëpunimi, do të kryhet në formë shkresore dhe do të konsiderohen si të dorëzuara rregullisht nëse dorëzohen dorazi, me postë të regjistruar, me postë elektronike ose me faks. Për kryerjen e kësaj procedure me efikasitet, palët caktojnë personat e kontaktit që janë përkatësisht:

Për ASIG:

Person Kontakti: Dritan Domi (Drejtor i Drejtorisë së Koordinimit dhe Projekteve)

E-mail: dritan.domi@asig.gov.al

Mobile: 0682038230

Për ASPA:

Person Kontakti: Dafina Dodoveci (Përgjegjës i Sektorit të Trajnimit dhe Komunikimit)

E-mail: dafina.dodoveci@aspa.gov.al

Mobile: 0696786675

Palët i komunikojnë njëra-tjetrës ndryshimet e mundshme të përfaqësuesve.

Neni 8

Dispozita të Përgjithshme

8.1 Ndryshimet ose shtesat e pjeshme që do t'i bëhen kësaj kontrate do të jenë të vlefshme vetëm nëse bëhen me miratimin dhe nënshkrimin e të dyja palëve.

8.2 Kjo marrëveshje është e hartuar në dy kopje në gjuhën shqipe, nga një kopje për secilën palë.

PËR

**AUTORITETI SHTETËROR PËR
INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR**

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Vilma Tomço



PËR

**SHKOLLA SHQIPTARE E
ADMINISTRATËS PUBLIKE**

DREJTOR I DELEGUAR

Arlinda Hoti

